



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 599/6 prot.

Tiranë më 07.05.2024

REKOMANDIM

Nr. 04, datë 07.05.2024

PËR KONTROLLUESIN SHKOLLA JOPUBLIKE
“WORLD ACADEMY OF TIRANA”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit Shkolla Jopublike “*World Academy of Tirana*” (në vijim, “*Kontrolluesi*),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 53, datë 29.02.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri e regjistruar me numër identifikimi K72411007G në Tiranë, me emër tregtar “*Montessori Albania SHPK*”, e cila ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit për nivelin parashkollor, arsimin fillor, nëntëvjeçar dhe të mesëm, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

\Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “nxënës”, “prindër”, “staf akademik (shqiptar dhe të huaj)”, “punonjës”, “vizitorë”, etj.

2. Kontrolluesi aplikon formularin “*Student Application Form*”, i cili plotësohet nga prindërit përpara regjistrimit të fëmijës në shkollë.

Nga analizimi i formularit rezulton se, ndër të tjera Kontrolluesi mbledh të dhëna për prindërit ose kujdestarët ligjor lidhur me pozicionin e punës si “*email i punës, adresa e punës, tel. i punës*”, si dhe lidhur me pjesëtarët e familjes (motër ose vëlla) të dhënat si “*emër, gjini, ditëlindje*”, në kundërshtim kjo me parimin e mjaftueshmërisë sipas gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kategoritë e të dhënave të mbledhura/ruajtura, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, si dhe mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

3. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për stafin akademik dhe nxënës në arkivën fizike, si dhe në Zyrën e Sekretarisë. Konstatohet se në ambientet e Kontrolluesit ruhen dosje të punonjësve të larguar (*në të cilën gjenden dokumente si CV, Job Offer, Kontratë pune, Certifikatë e aktit të lindjes, kopje ID/Pasaport, etj.*) ose dosje të fëmijëve të larguar (*e cila përmban dhe kontratën që lidhet me prindin, ku përpunohen të dhënat e tyre*).

Nga analizimi i rregullores së brendshme si dhe dy rregulloreve “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me gurmën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara nga Kontrolluesi në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, si “*dosje të mësuesve të larguar*”, duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojnë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

4. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejjimit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, për qëllim të sigurisë së personelit, nxënësve dhe pronës.

Nëpërmjet sistemit të video-survejjimit mblidhen dhe përpunohen të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave dhe ruhen për një periudhë mbi 60 ditë, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, si dhe me parashikimin e germës “c”, të pikës 4 të Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejjimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejjimit duhet të ruhen për një periudhë deri në dy muaj, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave imazheve/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit dhe të germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejjimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejjimit të miratuar nga Komisioneri.

Rezulton se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të parashikoj rregulla/politika dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesi i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

5. Kontrolluesi disponon llogari në platformën “Facebook” dhe “Instagram”, si dhe faqe web “https://wat.al/” në të cilin pasqyron aktivitete të zhvilluara, ndër të tjera, duke i ilustruar/publikuar online nëpërmjet fotografive dhe videove të nxënësve të shkollës, të marra gjatë aktiviteteve mësimore, kulturore, festa, etj.

Kontrolluesi ka lidhur “Kontratë Regjistrimi” me prindin, në lidhje me pagesat mujore të shkollës dhe në përmbajtjen e saj ka të parashikuar “Prindi/Kujdestari bie dakord të lejojë Shkollën, ose palët e treta të kontraktuara nga Shkolla, të marrin imazhe me lejen e Shkollës dhe të publikojë imazhe të nxënësve dhe të prindërve për qëllime specifike të shkollës të lidhura me objektin e Kontratës. Kjo për të demonstruar procesin e punës kur këto imazhe janë marrë apo regjistruar në mjediset e shkollës dhe/ose të lidhura me aktivitetet e shkollës brenda ose jashtë ambienteve të saj”, por konstatohet se informimi përmes këtij shënimi nuk është në përputhje me nenin 18 të Ligjit.

Për sa më sipër rezulton se informimi i realizuar nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave është shumë i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

6. Kontrolluesi disponon faqen web “https://wat.al/”. Konstatohet se, Kontrolluesi ka të publikuar rubrikën “Privacy Policy/Politikat e Privatësisë” në gjuhën angleze, të cilat janë modele standarde ndërkombëtare të politikave të privatësisë.

Subjektet e të dhënave personale nuk informohen në gjuhën shqipe subjektet e të dhënave (klientë, vizitorë), për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për

çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

7. Kontrolluesi ka lidhur Kontratë Shërbimi me kompaninë “ARB-SECURITY SHPK”, me objekt “...ruajtja me Roje Fizike të Objekteve të Montessori Albania SHPK”.

Nga verifikimi në vend, rezulton se Roja Fizike ka akses në sistemin e video-survejitimit CCTV, për kamerat e vendosura në pjesën e oborrit dhe parkimit. Gjithashtu, Roja Fizike disponon një “Regjistër hyrje-dalje i vizitorëve të jashtëm në objekt”, ku mban të dhënat e vizitorëve si “emër, mbiemër, ID, data, ora, funksioni, personi i autorizuar, punonjësi i shërbimit”.

Për sa më sipër, rezulton se, në përmbajtje të Kontratës nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

8. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës në kundërshtim me parashikimin e nenit 21 të Ligjit.

Megjithatë, në datë 25.03.2024 (pas fillimit të hetimit administrativ), ka dorëzuar Formularin e Njoftimit. Nga analizimi është konstatuar se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- Deklarimin në rubrikën 3.1, të formularit të njoftimit “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”;
- Deklarimi në rubrikën 5.1, të formularit të njoftimit “Të dhëna sensitive që përpunohen”;
- Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “Marrësi i të dhënave personale” ;
- Deklarimi në rubrikën 8.1, të formularit të njoftimit “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale”;
- Deklarimin në rubrikën 9.1, të formularit të njoftimit “Mjetet e përpunimit të të dhënave personale”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre që i jep Ligji.

1. Kontrolluesi disponon rregullore të brendshme, si dhe rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, rregullorja nuk përfshin në mënyrë të detajuar proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, sipas proceseve përpunuese gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore datë 25.04.2024, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit ka bërë me dije se ka marrë masa për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara në përfundim të hetimit administrativ, si dhe ka deklaruar angazhimin në vijim, për rikuperimin e shkeljeve të tjera, duke paraqitur:

- Tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV);
- Publikimin e “Politikat e privatësisë” në gjuhën shqipe;
- Formulari i “Njoftimit” i përditësuar.

Gjithashtu, përfaqësuesi i Kontrolluesit u shpreh shprehet se: “jemi duke rishikuar edhe një herë si rregulloren e brendshme dhe rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave dhe pas miratimit do jetë e përmirësuar me gjetjet e procesverbalit”.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa që të rishikojë çdo proces përpunimi të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5 të Ligjit, të marrë masa që mbledhja e të dhënave personale nga ana e tij, të kryhet në mënyrë të ligjshme, informacioni të grumbullohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me këto qëllime, duke ju përmbajtur gjithashtu parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje rishikimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, si dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të përfshijë në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) menjëherë, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
- (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
- (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
- (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
- 9. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 07.05.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi